

Sharrcem Fakte

Sistemet e Certifikuara të Menaxhimit: ISO't

Në bazë të Politikës së Titan-it Sharrcemi ka filluar me zbatimin e Sistemeve Ndërkombëtare dhe Evropiane të Certifikuara të Menaxhimit. Departamenti i cilësisë së Sharrcem-it vazhdon të jetë shumë i ashpër në kërkesat e standardeve për analizat kimike dhe mekanike për t'ju ofruar konsumatorëve të vet cilësi të lartë e cila është e domosdoshme, për këto produkte të



rëndësishme për industrinë ndërtimore.

Sharrcemi qysh nga viti 2011, e ka përmbushur certifikimin për Sharrcem ISO 9001 lidhur me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve.


Një sistemi menaxhimit të cilësisë ISO 9001 e vendosë kornizën për monitorimin dhe menaxhimin e vazhdueshëm të kontrollit përgjatë të gjitha aktiviteteve. Si një standard për menaxhimin e cilësisë i njohur botërisht, i përcakton mënyrat për ta arritur dhe pikat referuese të performancës dhe shërbimeve të vazhdueshme.



Më 14 Nëntor, 2013, Sharrcemi është shpërblyer "Kompania Evropiane për Certifikim dhe Inspektim" me certifikatën për sistemet e menaxhimit të mjedisit.

ISO 14001 është një standard i pranuar ndërkombëtarisht i cili e përcakton se si të vendoset një sistem efektiv i menaxhimit mjedisor. Është i dizajnuar t'ju ndihmojë bizneseve të mbesin komercialisht të suksesshëm pa i anashkaluar përgjegjësitë mjedisore.

I përcakton standardet për lejimin e rritjes duke e zvogëluar ndikimin mjedisor të rritjes së vet. Sistemi ISO 14001 e ofron kornizën për përmbushjen e pritjeve në rritje të




konsumatorëve lidhur me përgjegjësinë korporative si dhe të kërkesave ligjore dhe rregullatorë.

Përmes këtij certifikimi, përkushtimi i Sharrcemi drejt mbrojtjes së mjedisit është theksuar edhe me shumë, e poashtu edhe është vlerësuar puna e kompanisë e cila i ndërmerr aktivitetet e veta duke i plotësuar standardet më të larta ekologjike. Menaxhmenti i Sharrcemit e ka vlerësuar si shumë inkurajues faktin se është shpërblyer dhe vlerësuar kontributi i kompanisë drejt mbrojtjes së mjedisit. "Me këtë certifikim janë vlerësuar investimet tona gjithëpërfshirëse që kanë rrjedhë nga përkushtimi ynë për mbrojtjen e mjedisit. Duhet të theksohet se mbrojtja e mjedisit është një nga objektivat dhe shtyllat kryesore të kompanisë, dhe kështu Sharrcemi do të vazhdojë ta modernizoj procesin e prodhimit, e që përmirëson aktivitetet e tona me ndikim në mjedis, nga EM"



"Kompania Evropiane për Certifikim dhe Inspektim" edhe në Dhjetor 2013 e ka shpërblyer Sharrcemin me një nga certifikatat e saj.

ISO OHSAS 18001 është kornizë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. I përcakton politikat, procedurat dhe kontrollet që janë të nevojshme në organizatën tuaj për ti krijuar kushtet më të mira të mundshme për punë, në harmoni me praktikën e pranuar ndërkombëtare.



Vlerësimi me këtë certifikatë ka lartësuar edhe më shumë kontributin e Sharrcemit, duke marrë parasysh që shëndeti dhe siguria e të punësuarve është me rëndësi të madhe për Sharrcemin dhe se fabrika ka për qëllim të krijojë një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës. Menaxhmenti i Sharrcemit shprehur përmbajtjen e tyre se është vlerësuar kontributi i fabrikës ndaj shëndetit dhe sigurisë së punonjësve. "Me këtë certifikim është shpërblyer, angazhimi Sharrcemit ndaj kujdesin për shëndetin dhe sigurinë në punë, i cili përfshin trajnimin e të punësuarve lidhur me departamentet e tyre të punës, trajnimin e ndihmës së parë, si dhe trajnimin e punonjësve për të çuar më tej ndërgjegjësimin mbi shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Duhet të theksohet se shëndeti dhe siguria janë ndër qëllimet tona kryesore, dhe ne do të vazhdojmë të krijojmë kushte më të mira dhe më të sigurt në vendin e punës, duke promovuar edhe më shumë vlerën e shëndetit të të punësuarve tanë. Nga EM "

SHARRCEM

a TITAN Group Company



Group Corporate Values

INTEGRITY



KNOW-HOW

VALUE TO CUSTOMER



DELIVERING RESULTS
DELIVERING RESULTS

CONTINUOUS SELF-



CORPORATE SOCIAL RESPONSIBILITY

